



## **Numrat e emergjencës**

**Policia: 133**

**Policia me SMS për personat e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim: 0800 133 133**

**Shërbimi i Ndhmës: 144**

**Linja e ndihmës së grave kundër dhunës: 0800 222 555**

**Telefonat e emergjencës evropiane: 112**

**Ndihma emergjente në Austrinë e Epërme : 0732 2177**

**Këshillim telefonik në Austrinë e Epërme: 142**

**Ndihmë për këshillime: 147**

## **Çfarë është dhuna ndaj grave?**

Dhuna ndaj grave përfshin, për shembull: fyerje dhe poshtërime, cyberbullizëm, përcmime, kërcënime, intimidime të qëllimshme, trafikimi i grave, prerja e organeve gjenitale femërore, izolimi, kontrolli i tepruar, terrori psikologjik, goditje, sulme seksuale, ngacmim, goditje, përdhunim, mbytje, martesë e detyruar dhe sulme të tjera fizike deri në vrasje etj. Kjo dhunë ndodh zakonisht në shtëpi. Për këtë arsye, kjo dhunë quhet dhunë në familje. Dhuna në familje ndodh ndërmjet njerëzve që njihen mirë me njëri-tjetrin.

## **Dhuna në familje është e ndaluar.**

Për këtë arsye ekziston Ligji i Mbrojtjes nga Dhuna. Ky ligj ka për qëllim të mbrojtë të gjithë njerëzit nga dhuna. Gratë përjetojnë dhunë më shpesh. Ne duam të motivojmë të gjitha gratë. Merrni ndihmë!

## **Shihni dhe veproni**

Çdo person që vëren dhunë ndaj grave është i ftuar të ndihmojë dhe të mbështesë.

## **Merrni ndihmë dhe mbështetje te:**

**Policia 133**

Nëse thirret Policia, mund të lëshojnë një ndalim hyrje dhe afrim për dy javë. Policia ndalon agresorin të hyjë në shtëpinë e viktimës ose ti afrohet personit në rrezik. Policia merr çelësat nga agresori dhe atij i jipet një fletë informuese për mundësitë e akomodimit. Policia kontrollon respektimin e ndalimit të hyrjes brenda tri ditëve të para. Qendra për Mbrojtjen nga dhuna njoftohet nga Policia për çdo ndalim hyrjeje.

Qendra për Mbrojtjen nga Dhuna këshillon dhe mbështet gratë. Personat, ndaj të cilëve është lëshuar një urdhër për ndalim hyrje dhe afrimi, janë të detyruar të marrin pjesë në një këshillim gjashtë orësh.

**Policia me SMS për personat e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim: 0800 133 133**

**Qendra për Mbrojtjen nga Dhuna Ne Austrinë e Epërme 0732 60 77 60**

Kjo qendër njoftohet automatikisht nga policia në rast të lëshimit të urdhërit për ndalim hyrje apo afrim.

Qendra për Mbrojtjen nga Dhuna (në Linz dhe në degët e saja në Austrinë e Epërme) kontakton viktimën aktivisht për të ofruar ndihmë. Personat e prekur dhe ata që janë të lidhur ngushtë me ta mund të drejtohen NË ÇDO MOMENT për ndihmë te Qendra për Mbrojtjen nga Dhuna. Detyrat përfshijnë mbështetje për vazhdimin e një ndalim hyrjeje dhe afrimi përmes një vendimi gjyqësor. Gratë gjithashtu mund të marrin shoqërim dhe këshillim. Viktimave u ofrohet këshillim ligjor dhe psikisocial gjatë procedimit penal.

office.ooe@gewaltschutzzentrum.at

[www.gewaltschutzzentrum.at/oberoesterreich](http://www.gewaltschutzzentrum.at/oberoesterreich)

### **Srehimoret e grave**

Srehimoret e grave ofrojnë mbrojtje dhe akomodim për gratë që janë viktima të dhunës dhe fëmijët e tyre. Sidomos kur nuk është e mundur të jetoni më në shtëpi. Këto strehimore janë të arritshme në çdo kohë dhe mund të pranohen në çdo orë. Srehimoret e grave ekzistojnë në Austrinë e Epërme në Braunau, Linz, Ried i. I., Steyr, Vöcklabruck, Wels.  
[www.frauenhaus.at](http://www.frauenhaus.at)

### **Strehim i përkohshëm për gratë**

Në këto shtëpi, gratë mund të qëndrojnë përkohësisht ose vetëm ose me fëmijët e tyre, kundrejt një qiraje të ulët. Këto shtëpi janë të disponueshme në të gjithë Austrinë e Epërme. Kontaktimi bëhet përmes Zyrave të Këshillimit për Gratë në Austrinë e Epërme.  
[www.frauenreferat-ooe.at/netzwerke](http://www.frauenreferat-ooe.at/netzwerke)

### **Këshillime për gratë**

Në Austrinë e Epërme, gratë mund të marrin mbështetje pa pagesë, anonime dhe konfidenciale për çdo pyetje që lidhet me jetën e tyre në 23 zyrat rajonale të këshillimit për gratë. Gratë mund të marrin mbështetje dhe këshillime psikologjike, shoqërore dhe ligjore. Ky këshillim mund të ofrohet pjesërisht edhe në gjuhën e tyre amëtare. Grave emigrante të prekura ose të kërcënuara nga dhuna në familje, mund t'u jepet statusi i pavarur i qëndrimit për informacion më të detajuar, mund të kontaktojnë gjithashtu zyrat rajonale të këshillimit për gratë në Austrinë e Epërme.

[www.frauenreferat-ooe.at/netzwerke.htm](http://www.frauenreferat-ooe.at/netzwerke.htm)

### **Këshillime Online për Gratë në Austrinë e Epërme**

Këshillimi Online për gratë Austrinë e Epërme ofron përgjigje për çështjet e grave, dhunën, problemet në lidhje, ndarjen, divorcet, konfliktet familjare, probleme digjitale, shërbime për gratë që duan të fillojnë një biznes, trajnim për punë, riorientimin e prindërve të vetëm dhe çështjet e prindërimit, këshillim ligjor për ligjin e familjes, shtatzënisë, diagnostikën prenatale, abortin etj.

[www.frauenberatung-ooe.at](http://www.frauenberatung-ooe.at)

### **Shërbimi shëndetësor**

Mjeku i përgjithshëm ose spitali janë shpesh pika parë e kontaktit për gratë që janë viktime të dhunës. Jo vetëm për lëndimet fizike, por edhe për pasojat e dhunës psikologjike. Konfidencialiteti siguron që përmbajtja e ndjeshmërisë të trajtohet me kujdes. Megjithatë, në raste të caktuara, ekziston detyrimi për të raportuar, për shembull kur jeta dhe shëndeti janë të rrezikuar.

### **Avokatura për Fëmijët dhe të Rinjtë**

Puna jonë fokusohet në interesat dhe nevojat e fëmijëve dhe të rinjëve në bazë të drejtave të fëmijëve në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve. Fëmijët dhe të rinjtë mund të marrin këshillim dhe mbështetje pa pagesë, për shembull, edhe nëse janë viktime të dhunës ose bullizmit.

[www.kija-ooe.at](http://www.kija-ooe.at)

### **Mbështetje për Fëmijët dhe të Rinjtë**

Një situatë stresuese edhe për fëmijët dhe të rinjtë është kur janë dëshmitarë të dhunës në familje, për shembull mes prindërve të tyre. Detyra e Mbështetje për Fëmijët dhe të Rinjtë është të mbështesë familjet në situata të tilla të vështira. Punonjësit social verifikojnë nëse një fëmijë është mjaft i sigurt. Prandaj, Mbështetja për Fëmijët dhe të Rinjtë njoftohet automatikisht për çdo largim të një personi nga shtëpia. Gjithashtu, si individ mund të kontaktoni Mbështetja për Fëmijët dhe të Rinjtë nëse jeni të shqetësuar për një fëmijë, të ri ose adoleshent.

[www.kinder-jugendhilfe-ooe.at](http://www.kinder-jugendhilfe-ooe.at)